

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

## Raport sondazhi

# Aqua Park Tirana



Shtator, 2024

## **Përmbajtja**

---

Rreth sondazhit .....	3
Demografia .....	4
Preferencat e pushuesve dhe eksperiencia në Aqua Park .....	5
Vlerësimi për kompleksin, tarifat dhe evoluimin e kushteve .....	10
Sugjerime .....	14
Aneks I – Pyetësi i sondazhit .....	15

## **Rreth sondazhit**

Kompleksi i pishinave “Aqua Park Tirana” tashmë është një pikë frekuentimi për të gjithë, ku argëtimi është kryefjala si për fëmijët dhe për të rriturit. Bashkia është kujdesur që të gjitha mjediset të jenë sa më të përshtatshme për të gjitha grupmoshat dhe grupet vulnerabël. Aqua Park Tirana ofron mundësitë për të pushuar me miq dhe familjarë, ku gjelbërimi, freskia, pishinat për të rriturit dhe fëmijët, lojërat ujore, mundësitë për ushqim të shpejtë, e bëjnë një destinacion të aksesueshëm brenda qytetit.

Ndër aktivitetet që organizohen në mjediset e kompleksit mund të përmendim:

- Kampionati Kombëtar i Notit;
- Yoga me profesionistë të fushës;
- Organizim ditëlindjesh dhe evente të ndryshme;
- Kurse noti;
- Kampe verore për fëmijë.

Aqua Park Tirana ofron për të gjithë pushuesit mundësi relaksimi dhe argëtimi:

- Pishina Olimpikë;
- Dy pishina rinore;
- Pishina familjare;
- Pishina e fëmijëve;
- Park lojërash;
- Bar & Restorant.

Në mjediset e kompleksit ka staf mjekësor për ndihmë të shpejtë gjatë gjithë ditës, ndërsa në çdo pishinë ka nga një ekip shpëtimi. Orari zyrtar është 09:00-18:00 dhe në fund të çdo dite bëhet filtrimi dhe pastrimi i ujit. Hyrja për fëmijët deri në moshën 4 vjeç është falas, për të rriturit gjatë javës hyrja është 1000 lekë përfshirë çadër, shezllong, rrëshkitëse për fëmijët dhe parkim.

Sondazhi ka për qëllim gjenerimin e të dhënave dhe marrjen e opinioneve rreth cilësisë dhe shërbimit në kompleksin e pishinave Aqua Park Tirana.

### **Objektivat:**

- a) Shpeshësia e frekuentimit të Aqua Park Tirana;
- b) Ambientet që shfrytëzohen më shumë në kompleks dhe arsyet e frekuentimit;
- c) Vlerësimi për menaxhimin nga Bashkia e Tiranës dhe rekomandimi tek të tjerët;
- d) Vlerësimi për administrimin, mirëmbajtjen, shërbimin, sigurinë etj.;
- g) Vlerësimi për tarifën e biletave, grupmosha deri 4 në vjeç, PAK si dhe grupmosha 4-12 vjeç;
- h) Sugjerime të hapura për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve në kompleksin e pishinave.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **15 gusht – 4 shtator 2024** dhe u anketuan **361** frekuentues. Anketimi u krye nëpërmjet **intervistave ballë për ballë** pranë kompleksit nëpërmjet një pyetësi<sup>1</sup> të strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura.

---



<sup>1</sup> Ankes I – Pyetësi i sondazhit

## Demografia

Nga totali i të anketuarve për këtë sondazh (361 frekuentues), **19%** janë të Njesisë Administrative Nr. 2, 18% banorë të Njesisë Administrative Nr. 5, përkatësisht 9% janë banorë të njësive administrative nr. 3 dhe 7, 8% banorë të Njesisë Administrative Nr. 1, 7% të njësive administrative nr. 7 dhe Lagjes 13, etj. (Grafiku 1).




**60%** e të anketuarve janë femra ndërsa 40% meshkuj (Grafiku 2). Grupmosha me pjesëmarrjen më të lartë në anketim rezulton (36 – 50 vjeç) në masën **33%**, 29% (18 – 35 vjeç), 17% (nën 18 vjeç), 12% grupmosha (51 – 65 vjeç) dhe mbi 65 vjeç me 9% (Grafiku 3).




## **Preferencat e pushuesve, eksperiencat dhe rekomandimi i Aqua Park**


**40%** e pushuesve pjesëmarrës në sondazh janë përgjigjur se e *frekuentojnë kompleksin* disa herë në javë, 24% ndonjëherë, 16% 1 herë në javë, 11% për fundjavë dhe 9% përditë (*Grafiku 4*).




Pishinat familjare rezultojnë ambientet *më të shfrytëzuara në kompleks (51%)*, pishina rinia (24%) pishina olimpike (20%), ndërsa ambientet e eventeve (5%) (*Grafiku 5*).




**67%** e të anketuarve janë përgjigjur se *frekuenetojnë Aqua Park* pasi kanë mundësi të argëtohen me miq apo familjarë, **24%** abonime për sport (kurse noti etj.), **13%** për të festuar ditëlindje apo evente të ngjashme dhe **7%** për kamp veror (*Grafiku 6*).



**66%** e të anketuarve janë përgjigjur se *zgjedhin Aqua Park* për afërsinë, **53%** e frekuentojnë për pastërtinë e ambienteve, **51%** për pastërtinë e ujit, **33%** për çmimin e favorshëm (parkim, shezllong dhe rrëshkitëse fëmijësh pa pagesë), **11%** e zgjedhin pasi s'ka variante të tjera (*Grafiku 7*).




**54%** e të anketuarve kanë vlerësuar shumë mirë *menaxhimin e Aqua Park nga Bashkia e Tiranës*, **35%** mirë, **8%** mesatar, **2%** jo mirë dhe **1%** aspak mirë (*Grafiku 8*).





**85%** e të anketuarve janë shprehur se e rekomandojnë frekuentimin e kompleksit të pishinave Aqua Park Tirana tek të tjerët, 10% nuk e rekomandojnë, ndërsa 5% janë të pavendosur (Grafiku 9).

**Grafiku Nr. 9 Rekomandimi i Aqua Park Tirana tek të tjerët**



## Vlerësimi për kompleksin, tarifat dhe evoluimin e kushteve


Administrimi i kompleksit rezulton ndër të vlerësuarat më pozitivisht (**85%** janë përgjigjur mirë).

Pishinat, hapësirat për pushim, argëtim dhe piknik janë vlerësuar pozitivisht nga 84%.


Elementët e infrastrukturës së përgjithshme janë vlerësuar pozitivisht nga 79% e të anketuarve.

Shenjat sinjalizuese janë vlerësuar relativisht mirë (rreth 63% e të anketuarve kanë vlerësuar mirë dhe disi mirë).


Tualetet, dhomat e ndërrimit si dhe lojërat argëtuese janë vlerësuar disi më ulët krahasuar me elementët e tjerë, përkatësisht 54% dhe 58% (Grafiku 10).




**46%** e të anketuarve mendojnë se *tarifat e biletave* janë të përballueshme, **28%** janë shprehur se ato janë të larta, **17%** janë shprehur se janë të kënaqur nga tarifat, ndërsa **9%** nuk kanë dhënë një opinion (*Grafiku 11*).




**64%** e të anketuarve e vlerësojnë shumë mirë faktin që fëmijët *deri në 4 vjeç dhe PAK* përfitojnë hyrje falas në mjediset e kompleksit, 25% e vlerësojnë mirë etj. (Grafiku 12).




**52%** e të anketuarve e vlerësojnë shumë mirë faktin që grupmosha *4 – 12 vjeç* kanë një tarifë vetëm 200 lekë për hyrjen në mjediset e kompleksit, 20% e vlerësojnë mirë, 19% mesatare, 7% jo mirë dhe 2% aspak mirë (Grafiku 13).



**66%** e të anketuarve janë shprehur se e kanë *frekuentuar Aqua Park Tirana* edhe verën e kaluar, ndërsa 34% janë frekuentues për herë të parë këtë verë (*Grafiku 14*).



**43%** e të anketuarve që kanë frekuentuar edhe vitin e kaluar kompleksin e pishinave, janë shprehur se këtë vit nuk ka patur *ndryshime në kompleks*, 38% mendojnë se kushtet janë përmirësuar këtë verë etj. (*Grafiku 14/1*).



## **Sugjerime**

---

Të anketuarit kanë shprehur *sugjerime të hapura* me qëllim përmirësimin e infrastrukturës, shërbimit dhe aktiviteteve në Aqua Park Tirana:

*Tarifa për të rritur të jetë më e ulët;*

*Dhomat e ndërrimit të jenë higjenike;*

*Rikonstruksion total i kompleksit;*

*Duhet dezinfektim i ambienteve nga mushkonjat;*

*Pishina olimpike të jetë e dedikuar vetëm për notarë.*

## Aneks I – Pyetësoni i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësorit \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024

### Pyetësor – “Aqua Park Tirana”

#### Seksioni I: Demografia

Qyteti / Nj. Administrative	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				
	F	M	Nën 18	18 – 35	36 – 50	51 – 65	Mbi 65

#### Seksioni II: Pyetje

##### 1. Sa shpesh e frekuentoni kompleksin e pishinave Aqua Park Tirana?

Përditë    Disa herë në javë    1 herë në javë    Për fundjavë    Ndonjëherë

##### 2. Cilin prej ambienteve të kompleksit shfrytëzoni? (Mund të përzgjidhni më shumë se 1)

Pishinat familjare    Pishinën rinia    Pishinën olimpike  
Ambientet e eventeve

##### 3. E vizitoni Aqua Park Tirana për: (Mund të përzgjidhni më shumë se 1)

Argëtim me miq/familjarë  
 Festa ditëlindjesh apo evente të ngjashme  
 Abonime/sport (kurse noti)  
 Frekuentim të kampeve verore  
Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_

##### 4. Çfarë ju bën të vizitoni Aqua Park Tirana? (Mund të përzgjidhni më shumë se 1)

Pastërtia e ujit  
 Pastërtia e përgjithshme e ambienteve  
 Afërsia me Tiranën (Vendndodhja)  
 Çmimi i favorshëm (Parkim, shezllone dhe rrëshkitëse fëmijësh pa pagesë)  
 S'ka variante të tjera  
Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_

##### 5. Si e vlerësoni në përgjithësi menaxhimin nga Bashkia e Tiranës?

Aspak mirë – 1 2 3 4 5 – Shumë mirë

6. A do ta rekomandonit frekuentimin e Aqua Park Tirana tek të tjerët?

E rekomandoj  Nuk e rekomandoj  Nuk e di

7. Vlerësoni Aqua Park Tirana sipas elementëve të mëposhtëm:

Nr.	Elementët	Mirë	Disi mirë	Jo mirë	Nuk e di
1	<b>Hapësirat për pushim, argëtim dhe piknik</b> (Hapësirat e gjelbërta, snack-bar, stola, shezllone, çadra etj.)				
2	<b>Infrastruktura e Aquapark Tirana</b> (Dekori i jashtëm, rrugicat, hapësirat e dedikuara për evente etj.)				
3	<b>Pishinat</b> (Kapaciteti i pishinave, cilësia e ujit (PH), filtrimi, gjendja e klorit etj.)				
4	<b>Tualetet/dhomat e ndërrimit</b> (Numri i tualeteve, higjiena dhe materialet higjienizuese etj.)				
5	<b>Shenjat sinjalizuese</b> (Thellësia, grupmosha, rrëshqitëset etj.)				
6	<b>Ekipe të shpëtimit</b> (Siguria (life guard), mjeku etj.)				
7	<b>Lojërat argëtuese</b> (Tramoplina, rrëshkitëse etj.)				
8	<b>Administrimi</b> (Biletaria, oraret, stafi mirëmbajtës, shërbimi miqësor etj.)				
Tjetër					

8. Si i vlerësoni tarifat e biletave? (Përzgjidh vetëm 1)

Të kënaqshme  Të përballueshme  Të larta  Nuk kam mendim



9. Si e vlerësoni faktin që grupmosha deri në 4 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara përfitojnë hyrje falas në mjediset e kompleksit?

Aspak mirë – 1    2    3    4    5 – Shumë mirë

10. Si e vlerësoni faktin që grupmosha 4-12 vjeç gjatë javës kanë një çmim prej 200 lekë për hyrjen në mjediset e kompleksit?

Aspak mirë – 1    2    3    4    5 – Shumë mirë

11. A e keni frekuentuar dhe verën e kaluar Aqua Park Tirana?

Po     Jo

- Nëse po, si kanë evoluuar këtë vit kushtet?

Përmirësuar     Nuk ka ndryshime     Përkeqësuar     Nuk e di

12. Sugjerime për përmirësimin e infrastrukturës, shërbimit dhe aktiviteteve në Aqua Park Tirana?

---

**Shënim:** Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim vjeljen e opinionit të qytetarëve mbi cilësinë dhe shërbimin në "Aqua Park Tirana".

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"; Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".